REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE
TË BRENDSHME

BULETINI MUJOR

TETOR 2026

Buletini Mujor

10

Lajmet kryesore, vendimet dhe aktivitetet e Ministrisë së Punëve të Brendshme gjatë muajit tetor.

NË KËTË NUMËR

23 TET	Takim ndërkombëtar në San Patrignano: parandalimi i varësive dhe rehabilitimi
01 TET	Rritja e parametrave të sigurisë: takim me drejtuesit e Policisë
03 TET	Ulje të tarifave për dokumentet e identitetit për kategoritë në nevojë
05 TET	Ekipi i ri për pushtetin vendor
06 TET	Këshilli Vendor i Sigurisë në Shkodër
07 TET	Demo tek Akademia e Sigurisë: një standard i ri në Polici
09 TET	Interes i shtuar për Policinë e Shtetit
12 TET	Forumi Strategjik i Ballkanit: partneriteti Shqipëri–Greqi
13 TET	"Dhuna nuk justifikohet me të drejtën për protestë"
19 TET	Falënderim prindërve dhe thirrje të rinjve të largohen nga dhuna

LAJMI I MUAJIT

23 TETOR 2026 · ITALI

Takim ndërkombëtar në San Patrignano: Parandalimi i varësive dhe rehabilitimi, përgjegjësi e përbashkët

Itali – "Parandalimi, rehabilitimi dhe riintegrimi përbëjnë elemente thelbësore të një strategjie afatgjatë, me në qendër mbrojtjen e të rinjve dhe krijimin e mundësive konkrete për një jetë të shëndetshme e të sigurt", nënvizoi Ministri Demo gjatë një takimi ndërkombëtar për Parandalimin e Varësive dhe Rehabilitimin, në San Patrignano të Italisë, ku ishte e pranishme edhe Kryeministrja italiane, Giorgia Meloni, e homologë nga vende evropiane. Në fokus të takimit ishte rëndësia e një qasjeje të gjithanshme në luftën kundër drogës, e cila ndërthur sigurinë dhe zbatimin e ligjit me parandalimin e varësive, mbrojtjen e të rinjve dhe mbështetjen për rehabilitimin e riintegrimin në shoqëri të personave që përballen me varësinë.

POLICIA E SHTETIT 1 TETOR 2026

Rritja e parametrave të sigurisë, Ministri Demo takim me drejtuesit e Policisë në qendër dhe qarqe

Gjatë një takimi me drejtuesit e Policisë së Shtetit në qendër dhe në qarqe, Ministri Demo kërkoi informacion të përditësuar mbi situatën kriminale në territor, veçanërisht për zonat me risk, ku zhvillohet aktivitet kriminal në fushën e narkotikëve dhe lojërave të fatit, si dhe për lokalizimin dhe kapjen e personave në kërkim, me rrezikshmëri të lartë. Ministri kërkoi përdorimin e inteligjencës policore dhe ndërhyrje të befasishme ndaj personave që marrin guximin të qarkullojnë me armë zjarri, me qëllim parandalimin dhe goditjen e këtij fenomeni.

SHËRBIMET 3 TETOR 2026

“Ulje të tarifave për dokumentet e identitetit për kategoritë në nevojë, shërbim më i thjeshtë e afër qytetarit”

“Kemi nisur punën për uljen e tarifave të dokumenteve të identitetit për kategori të caktuara, që kanë më shumë nevojë për mbështetje”, u shpreh ministri Demo, gjatë një vizite në ambientet e “IdentiTek”. MPB dhe IdentiTek po punojnë për një shërbim më të shpejtë, më të thjeshtë dhe më të aksesueshëm. Procedura e zakonshme për pajisjen me dokument identiteti realizohet brenda 10 ditëve pune, ndërsa ajo e përshpejtuar brenda 3 ditëve pune. Po zgjerohet gjithashtu ofrimi i shërbimeve për shqiptarët jashtë vendit.

PROCEDURA E ZAKONSHME

10 ditë pune

për pajisjen me dokument identiteti

PROCEDURA E PËRSHPEJTUAR

3 ditë pune

për pajisjen me dokument identiteti

PUSHTETI VENDOR 5 TETOR 2026

Demo prezanton ekipin e ri për pushtetin vendor: Fokus te reformat, Kapitulli 22 dhe shërbimet ndaj qytetarëve

Ministri i Punëve të Brendshme, Ervin Demo, prezantoi ekipin e ri drejtues që do të ndjekë nga afër zhvillimet e reformat në pushtetin vendor, Oltjon Muzakën, zëvendësministër me fushë përgjegjësie për çështjet e pushtetit vendor, dhe Anxhela Paparizon, drejtoreshë të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore. “Na duhet koordinim më i fortë, lidership dhe angazhim maksimal nga i gjithë ekipi”, u shpreh Demo, duke vendosur si objektiv një pushtet vendor më të aftë, më modern dhe më pranë qytetarit.

POLICIA E SHTETIT
SIGURIA, PRIORITET
TË PUNOJMË SË BASHKU PËR NJË SHQIPËRI MË TË SIGURT
FORCOJMË BESIMIN
DËGJOJMË QYTETARËT
PUNOJMË SË BASHKU

SIGURIA NË TERRITOR 6 TETOR 2026 · SHKODËR

Në Këshillin Vendor të Sigurisë/ Ministri Demo: Bashkëpunimi në territor, formula për më shumë siguri dhe besim

Duke u ndalur te specifikat e Shkodrës, Ministri Demo theksoi se siguria publike është një kusht i domosdoshëm për zhvillimin e turizmit, krahas sigurisë në shkolla, qarkullimit rrugor, emergjencave civile dhe kontrollit të territorit. Ministri e cilësoi Këshillin Vendor të Sigurisë një instrument të pazëvendësueshëm në nivel lokal, pasi bashkon bashkinë, Policinë e Shtetit, strukturat arsimore, administratorët dhe aktorë të tjerë për të identifikuar problematikat reale në territor dhe gjetur zgjidhje të përbashkëta.

AKADEMIA E SIGURISË

AKADEMIA E SIGURISË 7 TETOR 2026

Demo tek Akademia e Sigurisë: Një standard i ri në Polici, nis nga brezi i ri

Duke përshëndetur studentët e rinj të Akademisë së Sigurisë, Ministri Demo, vuri në dukje nevojën për një polici moderne, profesionale e me integritet si dhe përgjegjësinë që mbart brezi i ri i Policisë së Shtetit. "Uniforma e shtetit është përgjegjësi, nuk është privilegj. Autoriteti që jep ligji duhet ushtruar me profesionalizëm, vetëpërmbajtje dhe integritet", tha Ministri, duke nënvizuar se qytetari duhet të jetë në qendër të punës së Policisë së Shtetit dhe se ligji vlen njëlloj për të gjithë.

> **"Uniforma e shtetit është përgjegjësi, nuk është privilegj."**
>
> Ervin Demo, Ministër i Punëve të Brendshme

REKRUTIMI 9 TETOR

Interes i shtuar për Policinë e Shtetit, rritja e moshës krijoi më shumë mundësi për kandidatë me përvojë

Ministri Demo ndoqi nga afër testimin e kandidatëve për Patrullën e Përgjithshme, ku vlerësoi interesin në rritje për t'iu bashkuar uniformave blu dhe risitë në procesin e rekrutimit. "Shifrat tregojnë që interesi ka ardhur në rritje për Policinë e Shtetit. Këtë vit kemi edhe një risi, pasi mosha është rritur nga 30 në 35 vjeç. Kjo tregon se Policia e Shtetit, duke marrë në konsideratë përvojën e saj, ka sjellë risi, që e bëjnë trupën e Patrullës së Përgjithshme shumë më efektive", u shpreh Ministri.

BASHKËPUNIM RAJONAL 12 TETOR

Demo në Forumin Strategjik të Ballkanit: Shqipëria dhe Greqia, partneritet për më shumë investime, siguri dhe integrim europian

Tiranë – Ministri i Punëve të Brendshme, Ervin Demo, mori pjesë në Forumin Strategjik të Bashkëpunimit Ballkanik, ku theksoi rëndësinë e thellimit të partneritetit strategjik mes Shqipërisë dhe Greqisë, përmes bashkëpunimit ekonomik, rajonal, akademik dhe në fushën e sigurisë. Në fjalën e tij, ministri Demo nënvizoi se marrëdhëniet mes dy vendeve mbështeten në lidhje historike, tradita të përbashkëta dhe bashkëpunim mes njerëzve, të cilat krijojnë një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e mëtejshëm të partneritetit.

RENDI PUBLIK 13 TETOR 2026

"Dhuna nuk justifikohet me të drejtën për protestë, ligji zbatohet njësoj për të gjithë"

"Shpreh shqetësimin tim për çdo person të lënduar, qoftë student, qytetar, gazetar apo punonjës policie, dhe u uroj të gjithëve shërim të shpejtë. Institucionet përgjegjëse do të publikojnë një bilanc të plotë e të verifikuar të të lënduarve. Dënoj pa asnjë rezervë sulmet ndaj punonjësve të Policisë, dëmtimin e pronës publike dhe private. Protesta paqësore është një e drejtë demokratike që shteti ynë e garanton plotësisht. Dhuna ndaj njerëzve dhe institucioneve nuk mund të justifikohet në emër të kësaj të drejte themelore," deklaroi Ministri Demo në lidhje me skenat e dhunshme përpara Ministrisë së Arsimit.

DEKLARATË 19 TETOR 2026

"Falenderim prindërve për bashkëpunimin, thirrje të rinjve të largohen nga dhuna dhe të respektojnë ligjin"

"Në emër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, duam t'iu drejtohemi me një falënderim të veçantë të gjithë prindërve dhe kujdestarëve, të cilët iu përgjigjën thirrjes sonë për bashkëpunim dhe shoqëruan fëmijët e tyre për frekuentimin e rregullt të orëve të mësimit. Së bashku me mësuesit e tyre, ata bënë të mundur që kjo të jetë një ditë normale për ta," – u shpreh në një deklaratë për mediat Anisa Ruseti, zëvendësministre e Punëve të Brendshme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE
TË BRENDSHME

mb.gov.al
Facebook · Instagram · X · YouTube